



## Pulsit Publik -VII-

Qershor 2014

**Përgatiti: UNDP Kosovë<sup>1</sup> - ekipi i Projektit Pulsi Publik:**

Atdhe Hetemi,  
Menaxher i Projektit të Pulsit Publik

Iris Duri,  
Statisticiente – Njësia për Politika, Hulumtim, Çështje Gjimore dhe Komunikim

Prishtinë  
*Qershor 2014*

---

<sup>1</sup> Për UNDP, çdo referencë e Kosovës në këtë dokument bëhet në kontekst të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999).

*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*



Ky dokument përmbledhës i Pulsit Publik –VII–, ofron pasqyrë koncize të treguesve e rezultateve kryesore të Sondazhit të Pulsit Publik. Të dhëna shtesë që merren nëpërmjet kësaj ankete do të vihen në dispozicion nëpërmjet dokumenteve të Analizës së Pulsit Publik dhe Dokumenteve të Veprimit.

### **Treguesit Kryesorë të Pulsit Publik**

Rezultatet e tanishme të Sondazhit të Pulsit Publik tregojnë se ka një rritje të përgjithshme të kënaqshmërisë së njerëzve sa i përket punës së institucioneve kryesore të ekzekutivit, legjislativit, dhe gjyqësorit. – mesatarisht, rreth 46% e kosovarëve duket se janë të kënaqur me institucionet (legjislative, ekzekutive, dhe gjyqësore bashkërisht).

Mes prillit të vitit 2013 dhe prillit të vitit 2014, niveli i kënaqshmërisë me punën e Qeverisë së Kosovës dhe punës së Kryeministrit u rrit për rreth 17 e 18 pikë në përqindje, dhe respektivisht, arritën nivelin më të lartë që nga prilli i vitit 2010.

Edhe institucionet ligjvënëse, siç janë Parlamenti dhe Kryetari i Parlamentit, kanë vërejtur rritje të nivelit të kënaqshmërisë me rreth 14 dhe 12 për qind. Presidentja, megjithatë, në mesin e të gjitha institucioneve, ka parë rritjen më të lehtë në nivelin e kënaqshmërisë që nga prilli 2013, prej vetëm rreth katër pikë përqindje.

Gjyqësori nuk paraqet ndonjë përjashtim sa i përket kësaj rritjeje të përgjithshme të kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e institucioneve kryesore të Kosovës. Niveli i kënaqshmërisë me punën e gjykatave të Kosovës është rritur me rreth 21 pikë përqindje që nga prilli 2013. Edhe niveli i kënaqshmërisë me punën e Prokurorisë ka shënuar rritje prej rreth 20 pikë përqindje dhe e ka çuar atë në lartësi prej 38% (në krahasim me vetëm 18% në prill 2013). (Shih tabelën 1).


*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*

*Tabela 1: Niveli i kënaqshmërisë me institucionet kryesore ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore*

		7-Mars	8-Maj	9-Qer	10-Prill	10-Nwn	11-Qer	12-Tet	13-Prill	14-Prill
Kënaqshmëria me qeverinë ekzekutive	Qeveria	30.5%	46.9%	53.1%	29.2%	25.1%	32.6%	27.2%	27.0%	44.2%
	Kryeministri	54.0%	72.0%	53.8%	36.4%	30.7%	37.6%	27.3%	30.4%	48.5%
Kënaqshmëria me ligjvënësin	Kuvendi	31.0%	51.4%	53.2%	34.1%	32.1%	41.0%	32.1%	32.3%	46.5%
	Kryetari i Parlamentit	35.4%	56.5%	51.6%	36.0%	33.3%	60.9%	44.7%	45.8%	57.8%
	Presidentja	52.0%	74.0%	61.7%	54.9%	30.8%	54.1%	47.1%	45.1%	48.8%
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykatat	20.0%	21.0%	32.7%	27.2%	18.5%	26.9%	24.3%	16.7%	37.5%
	Zyra e Prokurorit	22.7%	22.7%	31.7%	26.9%	15.1%	20.0%	15.0%	17.7%	38.1%


Ndërsa që duket se një numër i konsiderueshëm i kosovarëve është i kënaqur me punën e institucioneve kryesore – pamja ndryshon në mënyrë të konsiderueshme kur është fjala tek kënaqshmëria e tyre me orientimin politik në të cilin është duke shkuar Kosova. Vetëm rreth 21% e kosovarëve duket se janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me orientimin e tanishëm politik të Kosovës, ndërsa gati gjysma (42.5%) duket të jenë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me orientimin politik të Kosovës. Po ashtu, 36% kanë deklaruar se janë neutral sa i përket kësaj çështjeje (shih fig 1).

*Figura 1: Kënaqshmëria me orientimin politik të Kosovës*




Qytetarëve iu shtrua edhe pyetja lidhur me kënaqshmërinë që kanë rreth punës së Kuvendeve Komunale, rreth Administratës Komunale dhe Kryetarëve të komunave të tyre, që nga zgjedhjet e fundit komunale në vitin 2013. Rezultatet tregojnë se rreth 57% e kosovarëve kanë deklaruar se janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me punën e Kuvendeve të tyre Komunale që nga zgjedhjet e fundit komunale të vitit 2013. Shumica e kosovarëve (56%) kanë konfirmuar edhe atë se janë të kënaqur me punën e Administratave të tyre Komunale dhe me Kryetarët, që nga zgjedhjet e fundit komunale të vitit 2013. Ndërkaq, 32% kanë deklaruar se janë të pakënaqur me punën e tyre. Ngjashëm, 35% e qytetarëve kanë thënë se janë të pakënaqur me punën e Kuvendeve Komunale të tyre. Ndërsa rreth 11% e të anketuarve nuk kanë dhënë asnjë opinion apo se nuk dinë sa i përket nivelit të performancës së këtyre akterëve Komunalë (shih fig 2).

*Figura 2. Niveli i kënaqshmërisë me Kuvendin Komunal, Administratën Komunale, dhe Kryetarin e Komunës*



Përveç opinionëve mbi performancën e komunave, qytetarëve iu shtrua edhe pyetja rreth asaj se çka mendojnë ata se duhet të adresohet më me urgjencë në Komunitet e tyre. Rezultatet shpalosin se 56% e kosovarëve mendojnë se çështjet e zhvillimit ekonomik duhet të trajtohen urgjentisht, pastaj sistemi shëndetësor (11%), furnizimi me ujë (9.5%), dhe arsimiti (7.5%). Ndërkaq, vetëm rreth 6% e të anketuarve konsiderojnë se infrastruktura, ndotja, pastrimi i zonave të zakonshme dhe pikave të grumbullimit të mbeturinave kanë nevojë për përmirësim urgjent (*sibih fig 3*).

*Figura 3: Cila prej të mëposhtmeve, sipas mendimit tuaj, ka nevojë të ndryshohet apo përmirësohet më me urgjencë në komunën tuaj?*



Edhe pse korrupsioni vazhdon të mbetet fenomen me të cilin shoqëria kosovare është e shqetësuar, ka shënuar rënie përqindja e qytetarëve që mendojnë se korrupsioni është në shkallë të gjerë i pranishëm në institucione të ndryshme, krahasuar me prillin e vitit 2013. Institucionet për të cilat kosovarët kishin perceptimin se kanë prevalencën më të lartë të korrupsionit të shkallës së gjerë janë; ofruesit e kujdesit shëndetësor 40% (në krahasim me 50% në prill të vitit 2013), gjykatat 32% (në krahasim me 56% në prill të vitit 2013), Agjencia Kosovare e Privatizimit 24% (në krahasim me 49% në prill të vitit 2013), si dhe Korporata Energjetike e Kosovës dhe administrata qendrore/qeveria 24% (në krahasim me 49% dhe 46% përkatësisht në prill të vitit 2013). (shih tabelën 2).

*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*


Tabela 2: Perceptimet sa i përket korrupsionit të shkallës së lartë

	Nëntor -10	Qershor -11	Nëntor -11	Prill - 12	Shtator -12	Prill - 13	Prill - 14
Shëndetësia (spitalet)	47.9%	40.7%	49.8%	43.3%	51.6%	50.4%	40.4%
Gjykatat	49.7%	41.6%	55.6%	44.5%	47.5%	56.4%	32.2%
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	52.0%	40.5%	51.9%	49.4%	46.4%	48.7%	24.6%
Korporata Energjetike e Kosovës	52.4%	47.9%	61.2%	47.8%	53.8%	48.8%	24.4%
Administrata qendrore /qeveria	47.5%	41.4%	43.3%	39.5%	35.7%	46.1%	24.0%
Doganat	45.1%	42.3%	53.7%	43.2%	49.9%	58.9%	22.5%
Komunat (qeverisja lokale)	32.9%	30.4%	31.9%	30.1%	32.2%	38.9%	20.6%
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)		24.9%	36.5%	38.1%	33.6%	42.5%	16.5%
PTK	34.0%	32.4%	46.6%	41.8%	45.1%	41.4%	15.4%
Arsimi (shkollat, Universiteti)	14.4%	13.1%	17.3%	26.2%	23.5%	31.6%	13.0%
Bankat	14.4%	14.9%	22.0%	20.5%	22.8%	37.5%	12.0%
Policia lokale (ShPK)	15.2%	15.5%	19.5%	19.4%	28.0%	30.3%	11.5%
Policia e EULEXit (CIVPOL)	22.9%	26.2%	27.1%	28.3%	28.7%	38.3%	11.1%
Organizatat Ndërkombëtare	14.7%	12.3%	20.3%	19.3%	20.8%	24.8%	10.8%

Qëndrimet votuese në mesin e kosovarëve janë mjaft pesimiste, meqë ka një numër dukshëm më të lartë të të anketuarve që besojnë se vota e tyre nuk mund të ndryshojë situatën në Kosovë (37%), ose që nuk dinë nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën (16%). Analizuar mbi baza etnike, del se kjo pakënaqësi është më së shumti në mesin e serbëve (76%), pastaj tek pakicat tjera (43%) dhe tek shqiptarët (35%). Ndërsa vetëm 47% e votuesve potencialë besojnë se vota e tyre mund të ndryshojë situatën në Kosovë (shih figurën 4).


*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*

*Figura 4. A mendoni se vota juaj mund të ndryshojë situatën në Kosovë?*



Pulsi Publik ka kërkuar nga të anketuarit kosovarë edhe të dhëna rreth preferencave të tyre për votim, dhe rezultatet shpalosin se 54% e tyre kanë deklaruar se do të votojnë për parti apo koalicion konkret në zgjedhjet e qershorit të vitit 2014, ndërsa që 12% e tyre kanë deklaruar se nuk kanë preferenca politike. Për më tepër, është shënuar si përqindje serioze ajo e atyre që kanë deklaruar se nuk do të votojnë (13%), dhe e atyre që nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje (21%). (shih figurën 5)

*Figura 5. Preferencat për votim*




*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*



Rezultatet e hulumtimit të opinionit të muajit prill 2014 tregojnë se Indeksi i Demokratizimit (1.23) ka arritur nivelin më të lartë që nga nëntori i vitit 2010. Vetëm në krahasim me prillin e vitit 2013 indeksi është rritur me një mesatare prej 0.36. Ndërkaq, ndarë sipas gjinisë, nuk janë vërejtur dallime të mëdha në mesin e opinionëve të meshkujve dhe femrave sa i përket proceseve të demokratizimit në Kosovë. Megjithatë, marrë parasysh se Indeksi i Demokratizimit (ID) shtrihet nga 0 deri 3, Indeksi aktual na njofton se shumica e njerëzve nuk kanë mendim pozitiv rreth proceseve demokratike; prandaj kjo do të thotë se shumica e të anketuarve kanë mendim më negativ rreth proceseve demokratike në Kosovë. Ngjashëm me Indeksën e Demokratizimit, për Kosovën është llogaritur edhe Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE). IBE shtrihet prej 0 deri 3, ku indeksi prej 0 deri 1.5 do të thotë se shumica e kosovarëve nuk kanë besim në ekonominë (d.m.th. i shohin kushtet ekonomike si të pafavorshme; janë më pak optimistë për të ardhmen e ekonomisë). Në anën tjetër, IBE prej 1.5 e më lart, do të shpaloste se shumica kanë besimin në ekonomi, (d.m.th. i shohin kushtet ekonomike si të favorshme; janë më optimistë për të ardhmen e ekonomisë). Në të dhënat aktuale të sondazhit të Pulsit Publik, IBE në Kosovë është 1.04 (në krahasim me 0.68 në prill të vitit 2013), që tregon rritje të vogël pozitive që nga viti i kaluar, megjithatë shikuar mesatarisht, kosovarët nuk kanë opinion favorizues për ekonominë. (shih figurën 6)

*Figura 6: Indeksët e Demokratizimit dhe të Besimit në Ekonomi<sup>2</sup>*



<sup>2</sup> Shih faqen e fundit të dokumentit për informata të mëtuqeshme rreth llogaritjes së indekseve  
Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it

Në mënyrë që të përcaktohet ajo se cilët tregues kanë ndikuar në rritjen e Indeksit të Demokratizimit, të dhënat e muajit prill 2013 u krahasuan me ato të sondazhit aktual. Në mesin e komponentëve të Indeksit të Demokratizimit që kanë ndikuar në rritjen e përgjithshme të këtij indeksi janë zgjedhjet e lira dhe të drejta, dhe liria e mediave. Ndërkaq gjatë muajit prill të vitit 2013, vetëm 15% e të anketuarve besonin se zgjedhjet në Kosovë ishin demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare; në prill të vitit 2014, 37% e të anketuarve besonin se po. Një tjetër komponent që shpalosi rritje të konsiderueshme është besimi se media gëzon lirinë e shprehjes. Ndërkaq në muajin prill 2013 vetëm 25% e qytetarëve besonin se media gëzon lirinë e shprehjes, sondazhi i vitit 2014 raporton këtë numër të jetë në 45%. Kështu, rritja e këtyre dy komponentëve është rreth 21 pikë përqindjeje secila. Megjithatë, tregues të tjerë të demokratizimit për të cilat sondazhi Pulsi Publik ka mbledhur të dhëna demonstrojnë një rritje të besimit të qytetarëve në pavarësisë e gjyqësorit sa i përket vendim-marrjes (14%) dhe në aftësinë e parlamentit për të monitoruar performancën e Qeverisë (10%) etj. (shih tabelën 3)

*Tabela 3: Dallimet mes sondazheve të muajit Prill 2014 dhe Prill 2013, në aspekt të përqindjeve të përgjigjeve pohuese në pyetjet e Indeksit të Demokratizimit (përqindja e përgjigjeve nën opsionin “plotësisht pajtohem apo kryesisht pajtohem”)*

Kryesisht Po dhe Plotësisht Po	Nën-10	Qer-11	Nën-11	Prill-12	Tet-12	Prill-13	Prill-14
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në pajtim me standarde ndërkombëtare?	31.0%	29.3%	23.1%	17.0%	16.2%	15.0%	36.4%
A e monitoron Parlamenti performansen e Qeverisë?	20.7%	20.7%	19.4%	16.7%	17.7%	17.5%	28.5%
A është gjyqësori i Kosovës i pavarur në vendim-marrje?	13.2%	15.6%	11.3%	12.3%	15.7%	10.6%	24.8%
A gëzon media në Kosovë liri të shprehjes?	29.2%	33.9%	33.3%	34.7%	37.3%	24.6%	45.4%
A sherben Shoqëria Civile në Kosovë si	22.6%	18.9%	20.3%	19.0%	24.4%	18.3%	28.8%

*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*

monitorues i vërtetë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?							
A po punon Qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	27.7%	26.7%	29.0%	25.7%	27.3%	26.1%	32.6%
A punon Qeveria e Kosovës sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	14.3%	16.1%	14.6%	12.9%	15.3%	16.4%	26.4%
A është Kushtetuta e Kosovës si dhe Ligjet në fuqi demokratike si dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	32.6%	27.9%	26.5%	25.9%	26.0%	33.0%	35.3%
Pavarësisht politikës ditore dhe duke shikuar drejt të ardhmes, a pajtoheni se proceset demokratike në Kosovë janë institucionalizuar dhe janë duke shkuar në drejtimin e duhur?	25.6%	24.5%	17.9%	18.1%	18.6%	23.0%	33.0%


Ngjashëm me treguesit e Indeksit të Demokratizimit, përgjigjet pohuese aktuale në IBE u krahasuan me ato të muajit prill 2013. Edhe këtu është vënë në dukje se të gjitha komponentët luajtën rol në rritjen e përgjithshme të IBE. Rezultatet tregojnë se pritjet afatshkurtra (gjashtë muaj) sa i përket të ardhurave të përgjithshme të familjeve të tyre si dhe sa i përket kushteve të punësimit janë rritur për 9.5%, respektivisht 7.3%. Krahas kësaj, vlerësimi i të anketuarve në lidhje me kushtet aktuale të biznesit dhe punësimit ka parë po ashtu një rritje prej 6.8%, respektivisht 4.1%, në krahasim me muajin prill të vitit 2013. (shih tabelën 4)

*Tabela 4: Dallimet mes anketave të muajit Prill 2014 dhe Prill 2013, në përqindje të përgjigjeve pobuese në pyetjet ECI (përqindja e përgjigjeve nën opsionin “e favorshme”)*

<b>Të favorshme</b>	<b>Nën-10</b>	<b>Qer-11</b>	<b>Nën-11</b>	<b>Prill-12</b>	<b>Tet-12</b>	<b>Prill-13</b>	<b>Prill-14</b>
Çfarë pritjesh keni sa i përket të ardhurave totale të familjes tuaj pas gjashtë muajsh	16.8%	12.1%	8.5%	9.9%	9.6%	7.6%	17.0%
Si i vlerësoni kushtet aktuale për biznes	10.7%	9.7%	6.0%	7.9%	6.7%	4.8%	11.6%
Si i vlerësoni kushtet aktuale të punësimit	4.0%	3.3%	3.8%	3.4%	3.8%	5.1%	9.2%
Çfarë pritjesh keni sa i përket kushteve të punësimit pas gjashtë muajsh	14.3%	12.4%	8.0%	7.6%	7.4%	6.4%	13.7%


Megjithatë, edhe pse rritja është e dukshme sa i përket IBE, rezultatet e fundit nxjerrin në pah se ka më shumë pakënaqësi sa i përket orientimit ekonomik të Kosovës se sa orientimit politik të saj: rreth 62% e të anketuarve janë ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me orientimit ekonomik aktual të Kosovës, ndërsa vetëm rreth 12% janë të kënaqur me atë. Analizuar mbi baza etnike, të dhënat e sondazhit të opinionit tregojnë se përqindja e komuniteteve tjera të pakënaqura (76%) mbetet më e lartë se ajo e serbëve (71%) dhe shqiptarëve (61%) (shih figurën 7).

*Figura 7: Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës*




Nga 59% e kosovarëve papunësia perceptohet si një nga problemet kryesore me të cilat përballet Kosova. Përveç kësaj, të anketuarit gjithashtu ngelin të pabindur sa i përket punësimit në baza meritore në sektorin publik. Rezultatet e kësaj ankete tregojnë se 38% e kosovarëve besojnë që lidhjet familjare janë faktori më i rëndësishëm në punësim në sektorin publik, ndërkaj 18% besojnë se faktori më i rëndësishëm janë ryshfetet, pastaj 12% e kosovarëve mendojnë se bashkëngjitja në parti politike është faktori më i rëndësishëm për të fituar punësim në sektorin publik. Vetëm 17% e të anketuarve besojnë se arsimimi, përvoja profesionale dhe trajnimet profesionale bashkërisht janë të rëndësishme për të gjetur punësim në sektorin publik (*shih fig 8*).

*Figura 8: Perceptimet rreth punësimit mbi bazë meritore apo jo-meritore në sektorin publik*




Të anketuarve gjithashtu u është shtruar pyetja nëse në gjashtë muajt e fundit kishin pasur ndonjë situatë ku janë ndjerë të diskriminuar. Shumica e të intervistuarve, pa marrë parasysh kombësinë, u përgjigjën se nuk kishin perceptuar ndonjë diskriminim të tillë. Përveç kësaj, mes muajit tetor 2012 dhe prill 2014, ka pasur rënie të vazhdueshme tek përqindja e serbëve që besojnë se kishin qenë të diskriminuar në gjashtë muajt e fundit (22%). Ngjashëm, ka pasur edhe rënie në përqindjen e shqiptarëve dhe në përqindjen e të tjerëve që besojnë se në gjashtë muajt e fundit kanë qenë të diskriminuar (*shih figurën 9*).

*Figura 9: Ndjenja e të qenit i diskriminuar*



Teksa migrimi po bëhet sërish temë shqetësimi, qytetarët u pyetën edhe për atë se a kanë ndonjë plan për të mërguar nga Kosova. Rezultatet shpalosin se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve planifikon një gjë të tillë (22%). Gjashtë për qind e të anketuarve kanë deklaruar se nuk e dinë nëse do të migrojnë apo jo, apo nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje, ndërsa 72% e të anketuarve kanë konfirmuar se nuk kanë ndonjë plan për të migruar (*shih Figurën 10*).


*Figura 10. Plane për të migruar*



*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*

Kur ata që kanë në plan të migrojnë u pyetën mbi arsyet pse e shqyrtojnë migrimin si opsion, shumica prej tyre (41%) thanë se këtë e bëjnë për shkak të situatës jo të favorshme ekonomike të familjes së tyre. Ndërkaq, 39% e kosovarëve deklaruan se arsyet e tyre për migrim janë kërkimi i një të ardhme më të mirë për familjet e tyre dhe bashkimin familjar (13%). Në anën tjetër, 7% e kosovarëve duan të emigrojnë për shkak të mundësive më të mira arsimore, pakënaqësisë me gjendjen aktuale politike, krimin, dhe për arsye të sigurisë (shih figurën 11).


*Figura 11. Arsyet për migrim (për ata që kanë në plan të migrojnë)*



Si tregues i sigurisë, të anketuarit u pyetën edhe për atë se a ndihen ata të sigurt apo të pasigurt në rrugë. Të dhënat nga muaji prill 2014 shpalosin një rënie të madhe të numrit të njerëzve që ndjehen të sigurt; vetëm 60% e kosovarëve deklaruan se ndjehen të sigurt kur gjenden jashtë shtepie (krahasuar me 82% në prill të vitit 2013), ndërkaq vetëm 34% (për dallim prej 15% në prill të vitit 2013) ndjehen në përgjithësi të pasigurt. Kur këto të dhëna u analizuan sipas gjinisë, nuk u vërejtën dallime të mëdha në mes të përqindjes së femrave dhe meshkujve që ndjehen të sigurt në rrugë.




*Figura 12: Ndjenja e sigurisë*



Ballafaqimi me proceset e të kaluarës është përgjithësisht sfiduese për çfarëdo shoqëri që përballet me një të kaluar që karakterizohet me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Shumica e kosovarëve mendojnë se ballafaqimi me të kaluarën është i rëndësishëm. Rreth 87% konsiderojnë se nevoja e popullit të Kosovës për t'u marrë me zbulimin e së vërtetës për të gjitha krimet e luftës të kryera në të kaluarën, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të viktimave dhe autorëve të krimit, si "shumë të rëndësishme" ose si "deri diku të rëndësishme". Megjithatë, ndonëse janë vetëm rreth 3% që mendojnë se kjo çështje nuk është e rëndësishme, janë rreth 10% e kosovarëve të cilët ose nuk e dinë ose nuk kanë dhënë përgjigje në lidhje me rëndësinë e këtij procesi (*shih figurën 13*).


*Figura 13. Sipas mendimit tuaj, sa është me rëndësi për njerëzit e Kosovës që të merren me zbulimin e të vërtetës rreth të gjitha krimeve të luftës të kryera në të kaluarën, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të viktimave dhe kryesve (zëbërthyer sipas etnisë)?*



Edhe pse niveli i kënaqshmërisë së përgjithshme të popullit me punën e zyrës së prokurorit është rritur (shih tabelën 1), kur është fjala për ndjekjen penale të krimeve të luftës, rreth 12% e të anketuarve mendojnë se ky institucion është i njëanshëm. Derisa shumica e serbëve (82%) konsiderojnë se ndjekjet penale të krimeve të luftës janë duke u zhvilluar në favor të shqiptarëve, vetëm 12.5% e shqiptarëve mendojnë se ky institucion është i njëanshëm në favor të serbëve. Ndërkohë që shumica e komuniteteve tjera të Kosovës (48%) dhe shqiptarët (47%) mendojnë se ndjekja penale e krimeve të luftës në Kosovë trajton çdo rast në mënyrë të barabartë, vetëm 10.5% e serbëve besojnë po kështu. Megjithatë, një pjesë e madhe e etniciteteve të tjera (46%) dhe shqiptarëve (31%) kanë deklaruar se nuk e dinë ose nuk kanë dhënë përgjigje sa i përket ndjekjes penale të krimeve të luftës në Kosovë (shih figurën 14).


*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*

*Figura 14. Kur mendoni për ndjekjen penale të krimeve të luftës në Kosovë, cila nga deklaratat në vijim është më së afërmi me pikëpamjet tuaja (zëbërthyer sipas etnisë)?*



Të anketuarit kanë dhënë mendimet e tyre sa i përket asaj se cilat janë mënyrat më të përshtatshme për të zbuluar faktet e krimeve të kryera gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. Të njëzetë për qind e të anketuarve mendojnë se kjo gjë duhet të bëhet përmes fakteve të gjetura gjatë gjyqimit të krimeve të luftës, pasuar nga 13% që mendojnë se kjo gjë duhet të bëhet përmes punës së një komisioni të pavarur ndërkombëtar që do të hetonte ngjarjet e kaluara, dhe 11% që kanë deklaruar se kjo gjë duhet të bëhet përmes punës së organizatave joqeveritare që merren me hetimet e krimeve të luftës. Megjithatë, gati një e treta e kosovarëve (29%) nuk e dinë ose nuk dhanë përgjigje sa i përket asaj se cila është mënyra më e përshtatshme për të zbuluar faktet për krimet e kryera gjatë konfliktit të


*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*



armatosur në Kosovë. Kur këto të dhëna u ndanë sipas përkatësisë etnike, janë vërejtur dallime shumë të mëdha mes mendimeve të grupeve të ndryshme etnike.

Shumica e shqiptarëve të Kosovës mendojnë se mënyra më e përshtatshme për të zbuluar këto fakte është përmes gjykimeve të krimeve të luftës (30%), pastaj përmes punës së ndonjë komisioni të pavarur ndërkombëtar që do të hetonte ngjarjet e kaluara (13%), dhe nëpërmjet punës së organizatave jo-qeveritare që merren me hetimet e krimeve të luftës (11%). 23% e serbëve të Kosovës konsiderojnë se përmes ndonjë komisioni qeveritar të Serbisë, i cili do të hetonte ngjarjet e kaluara, është mënyra më e përshtatshme për të zbuluar faktet për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Megjithatë, 19.5% e serbëve e shohin si mënyrën më të përshtatshme që këto fakte të zbulohen përmes gjykimit të krimeve të luftës, pasuar nga 18% e tyre që mendojnë se mënyra më e mirë do të ishte përmes punës së ndonjë komisioni ndërqeveritar Kosovë-Serbe apo ndonjë komisioni ndërkombëtar të pavarur që do të hetonte ngjarjet e kaluara. Sa i përket komuniteteve të tjera të Kosovës; 43.5% kanë deklaruar se nuk e dinë se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme për të zbuluar krimet e luftës, pasuar nga 32.5% e pjesëtarëve të këtij komuniteti të cilët konsiderojnë gjykimin e krimeve të luftës si mënyrën më të përshtatshme për të zbuluar faktet rreth krimeve të kryera gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë (*shih figurën 15*).

*Figura 15. Sipas mendimit tuaj, cila është mënyra më e duhur për të zbuluar faktet rreth krimeve të luftës të kryera gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë (zëbërthyer sipas etnisë)?*




Vetëm 8% janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen se a mendojnë se anëtarët e komuniteteve të tyre kanë kryer krime lufte. Ndërkohë që 67% e të anketuarve deklaruan se anëtarët e komuniteteve të tyre nuk kanë bërë krime të luftës, 25% e tyre nuk e dinin apo nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*

Ndarë në baza etnike, u vu re se 31% e serbëve besojnë se anëtarët e komunitetit të tyre kanë kryer krime të luftës, dhe 49% e tyre nuk e besojnë këtë. Sa i përket shqiptarëve, vetëm 7% e tyre mendojnë se anëtarët e përkatësisë së tyre etnike kanë kryer krime të luftës, dhe 70% e tyre nuk mendojnë kështu. Ndërsa, kur është fjala për komunitetet tjera të Kosovës, 79% mendojnë se anëtarët e etnisë së tyre nuk kanë kryer krime të luftës, dhe 3.5% e tyre mendojnë se po.

*Figura 16. A mendoni se anëtarët e përkatësisë tuaj etnike kanë kryer krime lufte, apo jo (zëbërthyer sipas etnisë)?*



*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*

## Metodologjia

Këto rezultate bazohen në mostrën e sondazhit të opinionit që anketoi 1306 qytetarë të Kosovës mbi moshën 18 vjeçe, nga të gjitha gjinitë dhe nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke përfshirë edhe zonat rurale edhe ato urbane. Mostra ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës, dhe 200 nga pakicat jo-serbe të Kosovës (turq, boshnjakë, goranë, romë, ashkali, dhe egjiptianë). Metoda e sondazhit është metoda me mostër shumë-shkallëshe probabile të rastit. Mostra është përfaqësuese për ekonomitë-familjare në Kosovë. Hulumtimi është kryer nga Index Kosova (Prishtinë) gjatë fundit të muajit mars 10 dhe fillimit të muajit prill 2014.

## Vërejtje sa i përket shqyrtimit të totaleve

Sondazhet që ka kryer Pulsi Publik kanë qenë me mostrat e pakicës, me qëllim që të dhënat të zberthehen në aspekt të përkatësisë etnike, megjithatë, nëse duam të llogarisim shifrat totale, të dhënat duhen peshuar kundrejt shifrave të popullatës së përgjithshme.

Që nga viti 2002, me qëllim të peshimit të shifrave totale për Kosovën, në sondazhet tona janë përdorur përqindjet në vijim:

- K-Shqiptarë 88%
- K-Serbë 6%
- Të tjerë (Boshnjakë, Turq, Goranë, RAE) 6%.

Megjithatë, sipas regjistrimit të popullsisë dhe rezultateve zyrtare nga Enti Statistikor, përbërja etnike është si në vijim:

Përkatësia etnike	Popullata	Përqindja
K-Shqiptarë	1,616,869	92.93
K-Serbë	25,532	1.47

*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*

K-Turq	18,738	1.08
K-Boshnjakë	27,533	1.58
Romë	8,824	0.51
Ashkali	15,436	0.89
Egjiptianë	11,524	0.66
Goranë	10,265	0.59
Tjerë	2,352	0.14
Total	1,739,825	100.00

Po që se do të zbatonim shifrat e mësipërme në sondazhet tona, peshimi i shifrave duhet të jetë:

- 93% Shqiptarë
- 2% Serbë
- 5% Tjerë.

Marrë parasysh që serbët e pjesës veriore të Kosovës nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë, bashkë me pajtimin e përgjithshëm që shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës ishte më e ulët, kemi vlerësuar se duhet të shtojmë edhe një shifër tjetër prej 40,000 për serbët, duke arritur totalin prej 65,532. Kjo rrit edhe numrin total të popullsisë së Kosovës në 1,779,825.

Kur këto ndryshime merren në konsideratë, peshimi i të dhënave për sondazhet tona do të bëhet kështu:

*Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve në anketë dhe jo domosdo paraqesin qëndrimet e UNDP-së apo të USAID-it*



- 92% K-Shqiptarë
- 4% Serbë
- 4% Tjerë (Boshnjakë, Turq, Goranë, RAE)

### **Llogaritja e indekseve**

**Indeksi i Demokratizimit** është mesatare e përbërë e cila llogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve rreth nivelit se sa ata pajtoben ose nuk pajtoben me zhvillimin e proceseve të mëposhtme në Kosovë: Zgjedhjet e lira dhe të drejta, monitorimi nga ana e parlamentit rreth performancës qeveritare nacionale, sistemi i pavarur i gjyqësorit, liria e shprehjes dhe mediat, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, qeveria që bazohet në prioritetet e qytetarëve, të drejtat e njeriut në bazë të kushtetutës dhe ligjeve të vendit, si dhe rreth asaj nëse qeveritë lokale punojnë në bazë të prioritetëve të qytetarëve. Ky Indeks është masë e vazhdueshme e cila mund të shtrihet prej 3 (maksimumi), me të cilën nënkuptohet se të gjithë pjesëmarrësit janë pajtuar plotësisht se demokratizimi është në rrugën e duhur, e deri tek 0 (minimumi), që nënkupton se të gjithë pjesëmarrësit pajtoben se demokratizimi është në rrugën e duhur.

**Indeksi i besimit ekonomik** është mesatare e përbërë e cila llogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve rreth asaj se sa janë të favorshme ose jo të favorshme kushtet ekonomike që mbizotërojnë në Kosovë. Më saktësisht, të anketuarit vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet/pritshmëritë lidhur me të ardhurat totale të familjes dhe kushteve të punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, si dhe vlerësimit të kushteve aktuale për biznes dhe punësim. Vlerat mund të shkojnë nga 0 (minimumi) deri në 3 (maksimumi) ku shtrirja prej 0-1.5 tregon se vlerësimi është jo i favorshëm për situatën ekonomike, ndërsa vlerat prej 1,5-3 tregojnë se vlerësimi është kryesisht i favorshëm.